

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7072
E shtunë, 16 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

Mbi 4 000 regjistrime,
përfundon afati
për targat FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTJA VJOSA OSMANI KA MBAJTUR FJALIMIN VJETOR PARA
DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS FAQE 4-5

PRESIDENTJA MBAN FJALIMIN VJETOR NË KUVEND, BOJKOTOHET NGA DEPUTETËT E PDK-së DHE TË AAK-së

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka cilësuar vitin 2023 vitin më të vështirë për Kosovën sa i takon aspektit të sigurisë. Në fjalimin e saj vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Osmani ka thënë se Kosova më 24 shtator u përball me situatën më të vështirë që nga pavarësimi. "Sulmi i armatosur në Banjskë ishte vetëm një paralajmërim se Serbia nuk do të heqë dorë nga planet e saj të errëta", ka deklaruar Osmani. Gjatë fjalimit, i cili u bojkotua nga deputetët e partive opozitare, PDK-së dhe AAK-së, presidentja ka akuzuar Serbinë se qëllim ka destabilizimin jo vetëm të Kosovës, por të tërë rajonit të Ballkanit. Perëndimor, duke theksuar se Kosova nuk zbrapset, nuk thyhet dhe do t'i mbrojë kufijtë e vet në çdo cep dhe me çdo kusht



HAXHI SHALA DEKLAROHET I PAFAJSHËM NË HAGË F. 3



REAGIM I KMDLNJ-së
**EKUILIBRIMI
I PAMORALSHËM
I GJYKATËS
SPECIALE RACISTE
DHE EKATERINA
TRANDAFILOVËS** F. 3

AKTUALE



**HUNGARIA BLOKON 50 MILIARDË
EURO NDIHMË TË BE-SË PËR
UKRAINËN** F. 2

**"SHOIPËRIA TË MARRË MËSIM
NGA KOSOVA", TAHIRI: KUR LV-ja
E DOGJI KUVENDIN NE S'E
PËRJASHTUAM** F. 3

**PËRFAQËSUESIT E INSTITUCIONEVE
TË ENERGJISË DISKUTOJNË PARA
KOMUNITETIT TË BIZNESIT PËR
SIGURINË E FURNIZIMIT** F. 6

EKONOMI



**KUVENDI E MIRATON BUXHETIN
PËR VITIN 2024** F. 8

**ZRRE-JA SYNON PARANDALIMIN E
SULMEVE KIBERNETIKE, SFIDË
MBETET MOSLIBERALIZIMI I TREGUT** F. 8

SPORT



**PËRBALLJA E RIVALËVE NË
BASKETBOLLIN E KOSOVËS** F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli thotë se lufta me Hamasin do të zgjasë "disa muaj"

Jerusalem, 15 dhjetor - Ministri i Mbrojtjes i Izraelit, Yoav Gallant, ka paralajmëruar se lufta kundër Hamasit - grupit radikal palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja, do të zgjasë "më shumë se disa muaj".

Gallant i bëri këto komente në Tel Aviv me këshilltarin amerikan për Siguri Kombëtare, Jake Sullivan. "Por, ne do të fitojmë dhe ne do t'i shkatërrojmë ata", tha

Gallant.

Ndërkaq Shtëpia e Bardhë tha se Shtetet e Bashkuara duan që kjo luftë të përfundojë shpejt. "Mendoj se të gjithë ne duam që ajo të mbarojë sa më shpejt", tha zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, John Kirby.

Lufta, tani në muajin e tretë, nisi më 7 tetor, pasi Hamasi kreu një sulm tronditës në jug të Izraelit duke i vrarë 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe i rrëmbeu mbi 240 të tjerë. Prej atëherë, Izraeli e ka rrethuar

Ripin e Gazës dhe e ka rrethuar shumicën e saj. Ministria palestineze e Shëndetësisë tha të mërkurën se mbi 18 600 palestinezë janë vrarë, kryesisht fëmijë dhe gra, dhe rreth 50 000 të tjerë janë plagosur si pasojë e luftës izraelite në Gazë prej 7 tetorit. Avionët luftarakë e bombarduan edhe një ditë më parë Gazën dhe zyrtarët e organizatave humanitare thanë se shiu dimëror i ka përkeqësuar kushtet për



qindra mijëra njerëz që detyrohen të flenë në tenda të improvizuara.

Shumica e popullsisë prej 2.3 milionësh në Gazë ka mbetur pa strehë.

Hungaria bllokoi 50 miliardë euro ndihmë të BE-së për Ukrainën

BRUKSEL, 15 DHJETOR - Bashkimi Evropian ka dështuar të arrijë një pajtim për një paketë prej 50 miliardë eurosh ndihmë për Ukrainën, pasi Hungaria vuri veton ndaj ndihmës mbrëmjen e 14 dhjetorit.

Veprimi i Hungarisë, si goditje ndaj Kievit, vjen në kohën kur liderët e BE-së vendosën t'i hapin bisedimet për anëtarësimin e Ukrainës dhe Moldavisë në BE. Hungaria do të mund ta ndalojë procesin e anëtarësimin të Ukrainës në Bashkimin Evropian më vonë, nëse është e nevojshme, meqë BE kishte marrë një "vendim të keq" kur vendosi t'i fillojë bisedimet për anëtarësimin e saj, tha kryeministri Viktor Orban për radion shtetërore.

Ai tha se nëse BE-ja dëshiron ta ndryshojë buxhetin e saj aktual, atëherë do të jetë një "mundësi e madhe për Hungarinë të thotë se duhet të marrë paratë që ka të drejtë".

Miliarda euro fonde të BE-së, të destinuar për Hungarinë, mbeten të bllokuara për shkak të politikave të Orbanit lidhur me sundimin e ligjit, demokracinë dhe çështje të tjera që ishin shqetësuese për BE-në.

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, tha se "26 liderë ranë dakord" për ndihmën për Ukrainën, por duke iu referuar Orbanit, tha se "një udhëheqës



nuk mund të pajtohej". Ai bëri me dije se lideri i Suedisë kishte ende nevojë të konsultohet me ligjvënësit për çështjen e buxhetit, ndërsa shtoi se udhëheqësit e BE-së do ta rishikojnë çështjen e ndihmës për Ukrainën në një samit "në fillim të vitit të ardhshëm". Sipas tij, duhet ende përpunim i detajeve për këtë.

Opsione të tjera, për ndihmë për Ukrainën, mund të përfshijnë marrëveshje të veçanta kombëtare.

Kryeministrja e Estonisë, Kaja Kallas, tha: "Ukraina nuk do të mbetet pa mbështetje, ka mënyra

të ndryshme për ta bërë këtë", derisa shtoi: "Unë kam shumë besim. Do të kemi një zgjidhje deri në janar".

Liderët e Bashkimit Evropian vendosën të enjten t'i hapin bisedimet për anëtarësimin në BE me Ukrainën dhe Moldavinë.

Një ditë më parë Orban i largua nga salla kur po i hapej rruga procesit të anëtarësimin për Ukrainën, duke abstenuar kështu vendimin e BE-së.

Hungaria ka kohë të gjatë që e kundërshtonte nisjen e bisedimeve me Kievin, megjithatë nuk e përdori veton ndaj këtij

vendimi.

Kryeministri hungarez, i cili mban marrëdhënie të afërta me presidentin rus Vladimir Putin, beson se vendimi për anëtarësimin e Ukrainës është "plotësisht i pakuptimtë dhe i gabuar".

Putini nuk tregoi shenja të pendimit. Ai tha se mbështetja e Perëndimit për Ukrainën "mund të përfundojë në një moment dhe, siç duket, po i vjen fundi pak nga pak".

Ukraina dhe Moldavia aplikuan për t'iu bashkuar BE-së pasi Rusia e nisi pushtimin e plotë të Ukrainës në shkurt të vitit 2022.

Të enjten presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, e quajti vendimin për fillimin e negociatave me Ukrainën "një sinjal të qartë shprese për popullin e tyre dhe kontinentin tonë".

Edhe pse bisedimet nuk do të nisnin menjëherë dhe ato pritet të zgjasin disa vjet, presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelensky, e mirëpriti këtë vendim si "fitore për Ukrainën dhe të gjithë Evropën". Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se ky ishte një "vendim strategjik" dhe, sipas saj, dita e vendimit do të mbetet e shënuar në historinë e BE-së.

Të enjten blloku 27-anëtarësh miratoi gjithashtu një paketë prej dymbëdhjetë sanksionesh kundër Rusisë, tha presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel.

Samiti i 14 dhe 15 dhjetorit vjen pas vizitës së presidentit ukrainas në Uashington, ku nuk arriti t'i bindë ligjvënësit republikanë në Kongres që të zhblokojnë një paketë ndihme ushtarake dhe ekonomike me vlerë 60 miliardë dollarë për Ukrainën.

Udhëheqësit e BE-së pritej të kalonin në tema të tjera në ditën e dytë të samitit, duke përfshirë luftën e Izraelit me Hamasin, grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Njëmbëdhjetë policë të vrarë pas një sulmi në Iran

Rask, 15 dhjetor - Njëmbëdhjetë policë u vrarë dhe të tjerë u plagosën pasi një stacion policie u sulmua në Iran, raportoi televizioni shtetëror.

Autoritetet në qytetin Rask thanë se sulmi kishte ndodhur në orët e hershme të mëngjesit në jugperëndim të Teheranit. "Policia vrau disa nga sulmuesit në një

shkëmbim zjarri", tha zëvendësguvernatori Ali Reza Marhemati.

Sulmi pretendohet të jetë kryer nga grupi separatist i myslimanëve sunitë, Jaish al-Adl, sipas raportimit të televizionit shtetëror.

Në vitin 2019 ky grup kishte marrë përgjegjësinë për një sulm vetëvrasës me bombë në një autobus ku mbetën të

vrarë disa anëtarë të forcave të Gardës Revolucionare të Iranit.

Në muajt e fundit militantë dhe grupe të vogla separatiste në rajonin e banuar me shumicë sunite kanë sulmuar stacionet e policisë.

Provinca Sistan dhe Baluçistan është një nga zonat më pak të zhvilluara të Iranit.



Haxhi Shala deklarohet i pafajshëm ndaj akuzave të prokurorisë në Hagë



Hagë, 15 dhjetor - Ish-eprori i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Haxhi Shala, është deklaruar të premten i pafajshëm për pikat me të cilat e akuzon prokuroria në Hagë. Shala e ka bërë deklarin e tij të premten në konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, që njihen si Gjykata Speciale. Prokuroria në Hagë e ngarkon Shalën me aktakuzë me tri pika: tentativë për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, tentim për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi dhe për frikësim gjatë procedurës penale, tha të mërkurën në seancë gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou. Sipas aktakuzës, në periudhën midis 5 dhe 12 prillit 2023, Shala, bashkë me Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin (të dy të akuzuar nga Specialja), kontaktuan një dëshmitar. Aktakuza thotë se ata, veçmas, takuan dëshmitarin, në dy raste, "për ta nxitur atë që ta tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi në proceset zyrtare para Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndër të cilat, përmes kërcënimit të rëndë apo premtimit për përfitime". Kjo sjellje tregon se Shala synonte ta frikësonte dëshmitarin 1 dhe të pengonte persona zyrtarë, përfshirë prokurorë dhe hetues të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, në kryerjen e detyrave zyrtare, thuhet në aktakuzë, raporton REL. Në muajin tetor janë arrestuar dhe

kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, tentim pengimi të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi dhe për frikësim gjatë procedurës penale, tha të mërkurën në seancë gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou. Sipas aktakuzës, në periudhën midis 5 dhe 12 prillit 2023, Shala, bashkë me Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin (të dy të akuzuar nga Specialja), kontaktuan një dëshmitar. Aktakuza thotë se ata, veçmas, takuan dëshmitarin, në dy raste, "për ta nxitur atë që ta tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi në proceset zyrtare para Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndër të cilat, përmes kërcënimit të rëndë apo premtimit për përfitime". Kjo sjellje tregon se Shala synonte ta frikësonte dëshmitarin 1 dhe të pengonte persona zyrtarë, përfshirë prokurorë dhe hetues të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, në kryerjen e detyrave zyrtare, thuhet në aktakuzë, raporton REL. Në muajin tetor janë arrestuar dhe

transferuar në objektin e paraburgimit në Hagë edhe Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari, të cilët, sipas Speciales, akuzohen për "frikësim dhe tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përfshirë përmes kërcënimit të rëndë". Prokuroria ka propozuar, më 13 dhjetor, që çështja Januzi dhe Bahtijari të bashkohet me çështjen Shala në një gjykim të vetëm. Lidhur me këtë, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) pritet ta dorëzojë parashtrimin për një aktakuzë të përbashkët deri më 12 janar të vitit 2024, datë kjo që u bë e ditur nga urdhri i gjykatësit të procedurës paraprake, Nicolas Guillou, të premten. Kësaj kërkesë mbrojtja do të mund t'i përgjigjet jo më vonë se më 19 janar, ndërkaq kundërpërgjigja e prokurorisë mund të bëhet deri më 26 janar. Në konferencën mbi ecurinë e çështjes në rastin kundër Haxhi Shalës, u tha se afati i prokurorisë për nxjerrjen e materialeve është 26 janari, muaj ky që pritet ta shënojë përfundimin e hetimeve të prokurorisë në këtë çështje.

Sipas prokurorisë, materialet do të dorëzohen për të dyja lëndët "me shpresën që nga 26 janari të mund të bashkohen çështjet në një të vetme". Para gjykatësit të procedurës paraprake prokuroria bëri me dije se lloji i provave që synojnë të përdorin përfshin materiale të dokumentuara, të dhëna nga lidhjet telefonike, transkripto nga deklarata të ndryshme dhe dëshmitarë. Ndërkaq mbrojtja tha se gjatë arrestimit, Shalës i janë dhënë pak informacione lidhur me krimet për të cilat akuzohet. Si rrjedhojë, mbrojtja deklaroi se ka nevojë t'i shqyrtojë materialet dhe theksoi nevojën që prokuroria t'i dorëzojë të gjitha materialet e nevojshme në një kohë të përshpejtuar. Aktualisht në Gjykatën Speciale është duke vazhduar gjyqi i ish-pjesëtarëve të UÇK-së, njëherësh ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dy ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si dhe ish-anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rexhep

Selimi, me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të gjithë janë deklaruar të pafajshëm. Në një proces tjetër gjyqësor gjykohet ish-pjesëtari i UÇK-së, Pjetër Shala. Ai akuzohet për drejtimin e një burgu të improvizuar, ku supozohet se janë keqtrajtuar disa njerëz dhe një prej tyre është vrarë. Shala ka thënë se akuzat ndaj tij janë të fabrikuara. Më 14 dhjetor Paneli i Apelit në Gjykatën Speciale ka ulur për katër vjet dënimin ndaj ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa. Një vit më parë Mustafa ishte dënuar në shkallë të parë më 26 vjet burgim për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. Më herët nga Dhomat e Specializuara në Hagë janë dënuar Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj për pengim të administrimit të drejtësisë. Së fundi ata janë liruar me disa kushte. Këtë vit Specialja e ka arrestuar edhe ish-kryetarin e Malishevës, Isni Kilaj, me dyshime për pengim të drejtësisë.

"Shqipëria të marrë mësim nga Kosova", Tahiri: Kur LV-ja e dogji Kuvendin ne s'e përjashtuam

Prishtinë, 15 dhjetor - Ish-zëvendëskryeministrja e Kosovës, Edita Tahiri, ka komentuar përplasjet e pozitës dhe të opozitës në Shqipëri. Ajo ka kërkuar që shumica shqiptare të mos e përjashtojë nga Kuvendi

opozitën për veprimet e saj. Tahiri ka shkruar në "Facebook" se kur Lëvizja Vetëvendosje (LV) bënte veprime jodemokratike në Kuvendin e Kosovës, nuk ishte përjashtuar nga Kuvendi nga shumica e

atëherëshme parlamentare. "Kur opozita e LV-së dogji parlamentin ne që ishim në qeveri nuk e përjashtuam nga parlamenti. Shqipëria e sotme të marrë mësim demokratike nga Kosova", ka shkruar ajo.





PRESIDENTJA VJOSA OSMANI KA MBAJTUR FJALIMIN VJETOR PARA DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS

Presidentja mban fjalimin vjetor në Kuvend, bojkotohet nga deputetët e PDK-së dhe të AAK-së

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka cilësuar vitin 2023 vitin më të vështirë për Kosovën sa i takon aspektit të sigurisë. Në fjalimin e saj vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Osmani ka thënë se Kosova më 24 shtator u përball me situatën më të vështirë që nga pavarësimi. “[Sulmi i armatosur në] Banjskë ishte vetëm një paralajmërim se Serbia nuk do të heqë dorë nga planet e saj të errëta”, ka deklaruar Osmani. Gjatë fjalimit, i cili u bojkotua nga deputetët e partive opozitare, PDK-së dhe AAK-së, presidentja ka akuzuar Serbinë se qëllim ka destabilizimin jo vetëm të Kosovës, por të tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke theksuar se Kosova nuk zbrapset, nuk thyhet dhe do t’i mbrojë kufijtë e vet në çdo cep dhe me çdo kusht

vajza nga radhët e policisë, të cilët po atë ditë dhanë mesazh të qartë: Kosova nuk zbrapset, Kosova nuk thyhet dhe Kosova do t’i mbrojë kufijtë e saj në çdo cep dhe me çdo kusht”, ka thënë në ekspozenë e saj presidentja Osmani.

Presidentja e Kosovës ka thënë se sulmi në Banjskë ka prekur padyshim edhe përparimin në dialogun e Brukselit për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ky proces, sipas Osmanit, në vazhdimësi është duke u penguar nga, siç i quajti ajo, obstrukcionet e shtetit të Serbisë kundër Kosovës. Ajo i ka falënderuar përfaqësuesit e opozitës që në këtë çështje treguan përkrahjen për institucionet e Kosovës, në veçanti për institucionet e sigurisë, të cilat vazhdojnë të jenë mbrojtësit e Republikës sonë. “Ne jemi pak për të qenë të ndarë dhe me qëndrime të dallueshme për situata si kjo, kur vetëm uniteti është përgjigja e duhur për ta mbrojtur integritetin dhe sovranitetin e Kosovës. Këtë rrezik nuk e kemi kaluar, ndaj nuk duhet t’u nënshtrohemi ndarjes e dallimeve, por të jemi të bashkuar në vendosmërinë tonë në përballje me Serbinë e të qëndrojmë

këmbëngulës dhe të palëkundur kundrejt sfidave të sigurisë”, është shprehur presidentja.

Osmani ka kritikuar komunitetin ndërkombëtar për vendosjen e masave sanksionuese ndaj Kosovës. “Mungesa e balancës dhe qasjes së trajtimit të pabarabartë në dialog i ka bërë dëm jashtëzakonisht të madh këtij procesi. Kosova ende përballet me masa të padrejta dhe joproporcionale, të cilat prekin drejtpërdrejt interesin e qytetarëve të saj”, ka deklaruar Osmani.

Në të njëjtën kohë ishte kritike për mosvendosjen e masave të tilla edhe për shtetin e Serbisë që, sipas saj, ka qëllim kryesor destabilizimin e Kosovës dhe rajonit. “Në anën tjetër, duke mos vendosur masa ndaj Serbisë për aktin e agresionit të 24 shtatorit dhe për sulmin ndaj ushtarëve të KFOR-it dhe gazetarëve përgjatë majit, për fat të keq, ky shtet vetëm po inkurajohet të vazhdojë të përdorë dhunë”, është shprehur Osmani.

Presidentja Osmani tha se “një trajtim i tillë i pabarabartë do të jetë një goditje për kredibilitetin e procesit të dialogut dhe pengesa kryesore për progresin e këtij procesi”.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 15 dhjetor - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka mbajtur fjalimin vjetor të premtën para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Fjalimi i saj është bojkotuar nga deputetët e partive opozitare, PDK-së dhe AAK-së, ndërkaq deputetët e LDK-së kanë qëndruar në seancë.

Osmani e ka cilësuar vitin 2023 vitin më të vështirë për Kosovën sa i takon aspektit të sigurisë, duke theksuar se Kosova më 24 shtator u përball me “situatën më të vështirë që nga pavarësimi”. “[Sulmi i armatosur në] Banjskë ishte vetëm një paralajmërim se Serbia nuk do

të heqë dorë nga planet e saj të errëta”, ka deklaruar Osmani.

Gjatë fjalimit, presidentja e ka akuzuar Serbinë se qëllim ka destabilizimin jo vetëm të Kosovës, por të tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor. “Një grup terrorist e paramilitar, i financuar, trajnuar e mbështetur nga Serbia, mbi të gjitha i urdhëruar nga lidhshipi i këtij shteti, kreu akt agresioni me planin e qartë që të aneksohet veriu i Kosovës dhe të shkaktohet destabilizim jo vetëm i vendit tonë, por i gjithë rajonit”, është shprehur Osmani.

Ajo ka thënë se Kosova do t’i mbrojë kufijtë e saj në çdo cep dhe me çdo kusht. “Ky sulm, i cili është në vazhden e ideve e planeve

shoviniste e hegjemoniste të Serbisë, ekspozoi sërish fytyrën e vërtetë të fqinjit tonë verior, ëndërr e përhershme e të cilit mbetet realizimi i konceptit fashist të ‘Botës serbe’. Në këtë kohë kur është sfiduar drastikisht siguria në gjithë kontinentin tonë, plani famëkeq për destabilizim të Kosovës dhe rajonit mori përgjigjen e merituar”, ka theksuar presidentja Osmani. Sipas saj, në këtë ballafaqim, terroristët vranë policin Afrim Bunjaku, ndaj ai u bë dëshmorë dhe hero i ri në historinë e Kosovës dhe një nga të shumtët që ra fli në mbrojtje të integritetit dhe sovranitetit të Republikës sonë. “Ata vranë një, por mobilizuan shumë djem dhe

Reagim i KMDLNj-së

Ekulibrimi i pamoralshëm i Gjykatës Speciale raciste dhe Ekaterina Trandafilovës

Ekaterina Trandafilova ishte në një vizitë provokuese në Prishtinë me ç'rast u takua me një pjesë klienteliste të shoqërisë civile për t'i informuar për punën që e bën kjo Gjykatë.

Gjatë këtij rrugëtimi dezinformues u përballë me protesta të shoqëruara me tym dhe "zjarr" me ç'rast Policia e Kosovës përdori forcë të tepruar në mbrojtje të një manipuluese kundër drejtësisë dhe dashakeqe e të drejtave të njeriut dhe Kosovës, Katerina (Mediçi) Trandafilova. Pas takimeve me të

huajt e fuqishëm në Kosovë, u takua, fshehurazi me të ligjtë e Kosovës për ta vazhduar bashkëpunimin shumë të suksesshëm me ta edhe në të ardhmen dhe për të marrë bekimin e tyre për dënime drakonike sikur edhe për të siguruar "dëshmitarë të mbrojtur". Jo shumë kohë pas kësaj vizite të kurdisur, Gjykata e Apelit e GjRS shqyrtoi kundërshtimin e avokatit të Salih Mustafës për dënimin kapital prej 26 vjetëve që paraqet nonsens, krahasuar me dënimet që pati shqiptuar, për raste të

njëta Tribunali Ndërkombëtar për Krime Lufte për ish-Jugosllavi në Hagë dhe gjykatat e ngjashme në botë!

Në ndërkohë "njohësit" e çështjeve juridike deklarorin se dënimi do të ulet shumë shkaku se duhet të zbatohet ligji më i favorshëm për të dënuarin që ishte zbatuar ndaj një serbi të Hoçës së Rahovecit të cilit Gjykata ia uli dënimin e shkallës paraprake duke u thirrur pikërisht në këtë ligj. KMDLNj, pasi e ka shqyrtuar rastin nuk ka qenë optimist se do të ketë ulje të

ndjeshme të dënimit e as kthim të procesit në rishqyrtim. Ridënimi ndaj Salih Mustafës mbeti kapital ndërsa "zbutja" e dënimit ishte falso e sidomos arsyetimi për këtë zbutje. KMDLNj konsideron se Gjykata nuk ka arritur ta arsyetojë pretendimin për vrasje të një civilin nga Salih Mustafa, përkatësisht përgjegjësinë e tij direkte.

Ndërkaq, sa i përket aplikimit të ligjit më të favorshëm për të dënuarin, KMDLNj e përkujton opinionin se kjo mundësi nuk parashihet në Ligjin për Gjykatën Speciale prandaj edhe nuk zbatohet ndërsa, në rastin konkret GjRS e zbaton të Drejtën Zakonore Ndërkombëtare që ia mundëson shqiptimin e këtij dënimi. GjRS i ka hedhur në "kosh të plehrave" të gjitha kundërshtimet e avokatit të Salih Mustafës ndërsa "zbutjen" e dënimit e arsyeton me praktikën e ngjashme në Kosovë dhe në vendet tjera e jo se ka gjetur shkelje në vendimin paraprak. Kjo gjykatë vendimin e fillon dhe e mbaron duke u thirrur në "emër të popullit të Kosovës" që, përveç se është imoralitet i skajshëm, paraqet dhunim flagrant të vullnetit të popullit të Kosovës.

Për të balancuar krimin juridik kjo gjykatë, po të njëjtën kohë liroi me kusht Nasim Haradinajn, të cilin, bashkë me Hysni Gucatin e pati dënuar me një dënim drakonik për një vepër penale për të cilën realisht është dashur të dënohen pjesëtarë të GjRS që lejuan rrjedhjen e dosjeve të ndjeshme

pas së cilave, me pretekst të mbrojtjes së dëshmitarëve, i arrestuan dhe i dënuan. Ndonëse, të dy ishin dënuar me dënim të njëjtë, Hysni Gucati u lirua më herët ndërsa Nasim Haradinaj u lirua tash për ta mbuluar skandalin e ridënimin të Salih Mustafës. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj u liruan me kushte poshtëruese (mbyllje goje deri në fund të vitit 2024) gjë që nuk është praktikë e gjykatave tjera, ndërkombëtare e as vendore kur të dënuarit i liron me kusht. Me vet faktin se Katerina (Mediçi) Trandafilova është ajo që e ka "liruar" Nasim Haradinajn, pa asnjë dyshim tregon se prapa kësaj qëndron një marrëveshje e pistë dhe jo një vendim normal gjyqësor.

Kjo vetëm sa e përforcon bindjen dhe qëndrimin e KMDLNj-ës se kjo gjykatë vepron dhe gjykon në bazë të përkatësisë etnike dhe racore e jo në bazë të provave prandaj e ka kundërshtuar dhe e kundërshton fuqishëm. Koha do të dëshmojë se qëllimi i kësaj gjykate është politik dhe as që i intereson drejtësia për viktimat dhe përgjegjësia për ata që kanë bërë krime. Nuk ka qenë e as që është qëllim ballafaqimi me të kaluarën (nuk mund të bëhet ky proces në mënyrë të fragmentarizuar) por eliminimi i një garniture politike, stigmatizimi i UÇK-së, rishkrimi i historisë dhe ridizajnimi i proceseve politike, gjë që edhe po ndodh në praktikë!



Duke iu referuar draft-statutit për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, Osmani ka thënë se për këtë draft vlerësimin final duhet ta japë Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Por, para se të ndodhë kjo, Osmani i ka ftuar të gjitha partitë politike në Kosovë që të ulen së bashku dhe të shkruajnë komente të përbashkëta. "Qëllimi ynë i përbashkët duhet të jetë që të sigurojmë përputhshmëri të plotë me Kushtetutën e Kosovës dhe të mos lejojmë një pushtet të ndërmjetëm të qeverisjes apo anomali të tjera të cilat rrezikojnë funksionimin e brendshëm të shtetit tonë", ka thënë Osmani.

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, gjatë fjalimit vjetor në Kuvendin e Kosovës, ka theksuar se përgjatë këtij viti ka realizuar afër 200 takime dhe bashkëbisedime me krerë shtetesh e krerë qeverish, si dhe takime shtesë me udhëheqës të tjerë institucionalë e udhëheqës të organizatave më të fuqishme ndërkombëtare. "Jam krenare për punën që kemi bërë së bashku me ekipin tim në riparimin e shumë dëmeve që janë bërë nga kundërshtarët e Kosovës dhe parandalimin e shumë të tjerave, mbi të gjitha, për punën e bërë në përmirësimin e imazhit dhe pozitës së Kosovës

ndërkombëtarisht, përderisa jam e vetëdijshme se rrugë jo e lehtë na pret përpara në avancimin ndërkombëtar të vendit tonë", ka theksuar presidentja Osmani.

Sipas Osmanit, aplikimi për anëtarësim në Këshillin e Evropës është një dëshmi e përkushtimit ndaj vlerave demokratike, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës. "Njëkohësisht, dorëzimi i kërkesës së Kosovës për statusin e kandidatit në BE vë në pah përkushtimin tonë të palëkundur ndaj integritit dhe të ardhmes sonë evropiane", theksoi presidentja Osmani.

Osmani tha se, pavarësisht se sa komplekse është rruga, Kosova nuk do të heqë dorë nga anëtarësimi në BE, përkundër prej vonesave të padrejta që bëhen përgjatë kësaj rruge. "Duke pasur parasysh sfidat e sigurisë me të cilat ballafaqohet Kosova dhe i gjithë rajoni ynë, jam më e bindur se kurrë, se anëtarësimi ynë në NATO duhet të jetë prioriteti ynë numër një. Aspiratat tona për anëtarësim në aleancën më të fuqishme ushtarake janë të vendosura, të bazuara në përkushtimin tonë për sigurinë dhe stabilitetin rajonal", ka thënë presidentja.

Osmani para deputetëve ka përmendur edhe çështjen e shqiptarëve të Preshevës, të Medvegjës e të Bujanocit të cilët po

PDK-ja dhe AAK-ja thonë se presidentja nuk ishte unifikuese

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, duke e arsyetuar bojkotimin e fjalimit të presidentes, ka thënë se Osmani, fatkeqësisht, ka vazhduar të sillet në shpërputhje të plotë me rolin e saj kushtetues për ta përfaqësuar unitetin e popullit. "Zonja Osmani si presidente ka heshtur edhe atëherë kur do të duhej ta ngrëhte zërin fuqishëm përballë sfidave që ka kaluar vendi ynë gjatë këtij viti si në planin e brendshëm ashtu edhe në planin e jashtëm.

Zonja Osmani si presidente që në krye të herës e ka braktisur rolin unifikues që do të duhej ta kishte sepse me vendimet, veprimet dhe mosveprimet e saj ka demonstruar njëanshmëri të thellë politike ndaj pushtetit dhe nënshtrim ndaj Albin

Kurtit. Fatkeqësisht, në rreth tri vjet të mandatit të saj si presidente nuk shquhet për asnjë nismë të vetme, as në raport me gratë e as në raport me grupet e tjera shoqërore", ka thënë Tahiri. Po ashtu, ai ka thënë se duke qenë përfaqësuesja më e lartë e shtetit, Osmani si presidente ka dështuar tërësisht në përfaqësimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. "Asnjë njohje të re dhe asnjë anëtarësim në organizata serioze ndërkombëtare. Në aspektin e brendshëm jo vetëm që i ka mbyllur sytë përballë skandaleve dhe aferave korruptive të kësaj qeverie, por i është bashkuar fushatës qeveritare për t'i sulmuar institucionet e pavarura të drejtësisë dhe, në rastin më të

keq, duke e shkelur Kushtetutën në çështjen e mosdekremit të Kryeprokuroorit të Shtetit. Praktikisht, në vend se t'i mbështeste në mënyrë institucionale pavarësinë dhe integritetin e institucioneve të drejtësisë, ajo ka penguar punën e tyre, duke penguar kështu edhe luftën kundër korrupsionit dhe dukurive negative", ka thënë Tahiri. Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka treguar arsyen e bojkotit të fjalimit vjetor të presidentes Vjosa Osmani në Kuvend. "Kemi pritur nga presidentja të mbajë qëndrim unifikues në interes të vendit dhe jo të Kurtit dhe qeverisë. Për fat të keq, nuk kemi parë fare rolin e institucionit të presidentit. Më shumë e shohim si shërbim të Kurtit", ka thënë Haradinaj.

përballen me diskriminimin mbi baza etnike. Ajo ka thënë se duhet të lehtësohen procedurat e marrjes së nënshtrimit për bashkëkombësit tanë nga

Presheva, Medvegja dhe Bujanoci. "Kam propozuar që në ligjin e ri për shtetësi, i cili është duke u përgatitur, të parashihen lehtësira në procedurat e marrjes së

nënshtrimit për bashkëkombësit tanë nga Lugina dhe shpresoj që ky propozim do të përkrahët nga ju sapo të vijë në Kuvend", ka theksuar Osmani.

Kuvendi i Rahovecit miraton Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031

Rahovec, 15 dhjetor - Në seancë të jashtëzakonshme, të premtën Kuvendi Komunal njëzëri miratoi dokumentin strategjik më të rëndësishëm për komunën e Rahovecit, Planin Zhvillimor Komunal 2023 - 2031. Me këtë plan është paraparë zgjerimi i zonave ndërtimore, zonave të kombinuara për biznes (Ndërtim dhe zonat për biznese), si dhe ruajtja e zonave bujqësore. Po ashtu, parashihet shfrytëzimi i

tokave: 21,247.30 hektarë, prodhim parësor (bujqësi dhe pylltari); 1616.26 hektarë, prodhime dytësore (industri e lehtë dhe energji e ripërtërishme); 939.80 hektarë, prodhime tretësore; 547.38 hektarë, rrjet i transportit, logjistikë dhe infrastrukturë publike; 2757.3 hektarë për banim; dhe 399.07 hektarë për shfrytëzime të tjera. Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se ky dokument strategjik u hap rrugë

investimeve dhe zhvillimit ekonomik të kësaj komune. "I falënderoj për zemërsisht për angazhim dhe bashkëpunim, drejtorin e Urbanizmit Albnor Mullabazi, drejtorët e drejtorive komunale dhe të gjitha subjektet politike në Rahovec. Falënderues ndaj të gjithë anëtarëve të Kuvendit Komunal për diskutimet konstruktive dhe për përkrahjen e dhënë në miratimin njëzëri të PZhK-së!", ka thënë Latifi.



Përfaqësuesit e institucioneve të energjisë diskutojnë para komunitetit të biznesit për sigurinë e furnizimit

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Përfaqësuesit e kompanive të sektorit privat patën mundësi të mësojnë më shumë për aktivitetet e institucioneve përgjegjëse për sigurim të furnizimit me energji elektrike përmes bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike në Evropën Juglindore në një forum diskutimi të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Arben Nagavci, specialist i menaxhimit të projekteve në aktivitetin e USAID-it për Qëndrueshmëri Energetike, ofroi një perspektivë mbi zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë si dhe rolin e rëndësishëm që USAID-i ka pasur në avancimin e këtij sektori.

Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Ymer Fejzullahu, u fokusua në nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Evropës Juglindore. Ai theksoi rëndësinë e këtij bashkimi për integrimin e tregut pan-evropian të energjisë elektrike dhe sigurinë e përgjithshme të furnizimit me energji në rajon. Ndër të tjera, Fejzullahu foli edhe për krijimin e bursës së përbashkët dhe bashkimin e tregut me Shqipërinë si dhe funksionalizimin e ALPEX-it, duke theksuar se bursa e energjisë do të jetë çelësi i rritjes së transparencës në sektorin e energjisë.

Ndër temat që u diskutuan ishte edhe zhvillimi i Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë dhe përgatitjet e nevojshme të sistemit energjetik të Kosovës dhe kornizës



ligjore përkatëse për ta mbështetur prodhimin e energjisë elektrike nga këto burime.

Kryeshefi ekzekutiv i Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Evetar Zeqiri, foli për rëndësinë e pavarësimit energjetik të Kosovës tri vjet më parë, duke e konsideruar si arritje tejet të rëndësishme për sigurinë energetike, e cila jo vetëm që ofroi më shumë dy shtetet shqiptare, por edhe avancoi tutje bashkëpunimin tonë drejt një modeli të tregut të përbashkët

energetik të synuar. Zeqiri tha se rrjetet transmetuese duhet të jenë mundësuese, e jo fyte të ngushta drejt tranzicionit të pastër energjetik, ndërsa për të arritur këtë nevojiten investime për zgjerimin e mëtejshëm të rrjeteve, duke përmendur edhe planet ambicioze që KOSTT ka në këtë aspekt.

Ndërsa Rudina Heroi Puka, drejtoreshë për Kujdesin ndaj Konsumatorëve, Tarifa dhe Çështje Rregullative në Kompaninë e Furnizimit me Energji Elektrike

KESCO, si dhe bashkëthemeluese e Komitetit të Grave në Energji dhe Miniera, foli për rolin jetik që gratë luajnë në sigurimin e furnizimit me energji elektrike dhe integrimin e tregut duke sjellë aftësi, perspektiva dhe inovacione të ndryshme në sektorin e energjisë. Puka tha se përfshirja e grave kontribuon në zhvillimin e sistemeve energetike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe elastike, duke shtuar se inkurajimi i diversitetit dhe përfshirjes gjinore nuk është vetëm një çështje e drejtësisë sociale, por

edhe një qasje strategjike për adresimin e sfidave komplekse me të cilat përballet sektori i energjisë. Shkumbin Hysa, shef i degës ALPEX në Kosovë, sqaroi rolin e ALPEX-it dhe përfitimet për sektorin privat dhe investitorët potencialë, sidomos ata të interesuar në burimet e ripërtërishme të energjisë. Hysa përshkroi procesin për bizneset e interesuara për tregtimin e energjisë elektrike në ALPEX dhe theksoi rolin e tij në lehtësimin e qasjes në treg.

Kryetari i Skenderajt pret në takim 52 studentë të mjekësisë

Skenderaj, 15 dhjetor - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka pritur në takim 52 të rinj dhe të reja - studentë të mjekësisë - të cilët kanë përfunduar punën praktike në Qendrën Kryesore të

Mjekësisë Familjare në këtë komunë. "Uratat më të përzemërta për 52 të rinj e të reja studentë të mjekësisë, të cilët pas përfundimit të suksesshëm të punës praktike në Qendrën Kryesore të Mjekësisë

Familjare, për çka janë pajisur edhe me vërtetim për praktikë profesionale, bëhen zot të vetvetes si infermierë, duke u vënë në shërbim të pacientëve dhe qytetarëve në përgjithësi!", ka shkruar Nura në "Facebook".



12 500 adoleshentë dhe të rinj do të përfitojnë nga partneriteti në mes të UNICEF dhe ADA-s

PRISHTINË, 15 DHJETOR - UNICEF-i në Kosovë dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Njësia Operative e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim, vazhduan partneritetin e tyre edhe për tri vjet të tjera për t'i fuqizuar më shumë adoleshentë dhe të rinjtë. Partneriteti do t'i zgjerojë mundësitë për vajzat dhe djemtë adoleshentë në Kosovë që të zhvillojnë shkathtësi kyçe për jetë dhe

punë dhe do t'u mundësojë atyre të kontribuojnë në mënyrë aktive si agjentë për ndryshime sociale brenda komuniteteve të tyre. Në veçanti, partneriteti do t'i mbështesë edhe organizatat bazë që punojnë me të rinjtë, dhe synon t'i ndryshojë normat gjinore që mund t'i dekurajojnë të rinjtë dhe të rejtat nga ndjekja e mundësive që tradicionalisht lidhen me një gjini specifike.

UNICEF-i, me mbështetjen e partnerit të tij strategjik ADA, synon ta përmirësojë jetën e 12 500 adoleshentëve dhe të rinjve në këtë fazë të fundit. Bashkëpunimi do t'i përforcojë zërat e tyre, do t'i ndërtojë kapacitetet e tyre për t'u angazhuar në mënyrë aktive në vendimmarrje dhe do t'i pajisë ata me shkathtësi për t'i tejkaluar me sukses sfidat e tyre personale, shoqërore dhe ekonomike.



Përfundon afati për ndërrimin e targave, mbi 4 000 regjistrime

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Nga 16 dhjetori qytetarët të cilët nuk i kanë regjistruar veturat në RKS-Republika e Kosovës nuk do të lejohen të qarkullojnë në territorin e Kosovës me veturat që mbajnë targat me akronime serbe e që shteti i konsideron ilegale. 15 dhjetori ka qenë dita e fundit që të gjithë pronarët me targa si KM, PR, PZ, DE, UR e të tjera t'i kthejnë ato në targa të Republikës së Kosovës, konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë", Nora Fetoshi, zëdhënëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme. "Pas përfundimit të këtij afati, pra pas datës 15 dhjetor, qytetarët të cilët nuk i regjistrojnë veturat e tyre edhe pas vendimit të përcaktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, do të llogariten si pronarë të veturave të paregjistruara dhe veturat e tyre nuk do të lejohen të qarkullojnë në territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë këtu edhe pikëkalimet kufitare ashtu siç parasheh edhe legjislacioni në fuqi. Automjetet do të ndalohen nga policia e trafikut rrugor dhe do të gjobiten për kundërvajtje në trafik dhe tabelat do t'i largohen automjetit, ndërsa nëse e njëjta veturë do të haset përsëri në qarkullim, ajo veturë do të konfiskohet", tha Fetoshi. Afati për konvertimin e targave do të duhej të përfundonte më 1 dhjetor, por Qeveria e Kosovës e kishte zgjatur atë edhe për 15 ditë pasi ishin vërejtur radhë të gjata para qendrave për reregjistrim. Targat KM, dhe me akronime të



tjera serbe për qytetet e Kosovës, janë lëshuar nga autoritetet serbe dhe konsiderohen të paligjshme nga autoritetet në Kosovë. Sipas Qeverisë së Kosovës, nga 1 nëntori deri më 14 dhjetor, 3 405 qytetarë kanë konvertuar targat e tyre në RKS dhe komunat me numrin më të madh janë Mitrovica e Veriut dhe Leposaviqi. "Ndërsa nga tërë procesi prej vitit të kaluar janë gjithsej 4 210 konvertime

të tabelave", bëri me dije Fetoshi duke theksuar se, "përveç lehtësirave financiare, në afatin e kaluar, ne ndryshuam edhe udhëzimin administrativ në mënyrë që qytetarët tanë të komunitetit serbë në veri të mund t'i regjistrojnë veturat e tyre me targat e regjionit në të gjitha Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve pavarësisht prej vendbanimit apo vendqëndrimit të tyre".

Sipas Qeverisë së Kosovës, i tërë ky proces ka për qëllim ligjshmërinë dhe sigurinë në trafik. Qarkullimi i veturave me targa të tilla është toleruar deri më tani në veri, ndërsa në zonat e banuara nga serbët në jug të Ibrit ato ishin larguar nga përdorimi më shumë se dhjetë vjet më parë. Sipas përlloraritjeve të sektorit civil serb, në komunat në veri të Kosovës, të banuara me

shumicë serbe, ka pasur rreth 10 000 vetura me targa KM. Çështja e targave KM ka shkaktuar kriza në veri që çuan në protesta, daljen e serbëve nga institucionet dhe vendosjen e barrikadave. Tensionet në veri kulmuan më 24 shtator të këtij viti me një sulm të armatosur ndaj Policisë së Kosovës nga një grup i serbëve lokalë, ku mbeti i vrarë një polic i Kosovës dhe tre sulmues serbë.

Fillojnë angazhimin 359 specialistë

Prishtinë, 15 dhjetor - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka pritur në takim specialistët e ardhshëm, të cilët kanë nënshkruar kontratat e reja për specializim dhe kanë filluar shkollimin specialistik. "Për herë të parë ky proces është organizuar mbi bazën e tri parimeve profesionale:

Kuadri deficitar, kapacitetet mentoriale dhe kapacitetet infrastrukturore. Veç këtyre parimeve, gjithashtu për të parën herë specialistët janë përzgjedhur në bazë të përgatitjes individuale dhe kualifikimeve e jo në bazë të metodës së testimit. Andaj me bindje të thellë konsiderojmë se ky është procesi më cilësor

dhe më transparent që kishim deri më sot. Pra, kriteri themeltar ishte kriteri i meritokracisë. Në këtë takim specialistët janë pajisur me ditarin e specialistit, i cili do të shërbejë për rritjen e cilësisë gjatë shkollimit specialistik dhe do ta rrisë llogaridhënien", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.



ATK-ja lanson tri shërbime të reja elektronike për tatimpagues

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Në një ngjarje të organizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), e mbështetur nga Programi i USAID për Qeverisje Ekonomike në Kosovë, janë lansuar tri shërbime të reja elektronike për tatimpagues: (I) udhëzuesi interaktiv tatimor, (II) kalkulatorët tatimorë, si dhe (III) sistemi për denoncimin e parregullsisve tatimore. Këto shërbime elektronike do t'u ndihmojnë tatimpaguesve ta përmirësojnë të kuptuarit e

përmbushjes tatimore, ta bëjnë vlerësimin e obligimeve tatimore, si dhe të raportojnë evazionin dhe parregullsitë tatimore në mënyrë elektronike. Në këtë ngjarje mori pjesë zëvendësministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Avni Zogiani, i cili u shpreh shumë i kënaqur me shërbimet e ofruara për tatimpagues deri më tani. Ai shtoi se tri shërbimet e reja do të mundësojnë përfshirjen e sa më shumë tatimpaguesve

nën ombrellën e sistemit tatimor. Gjatë fjalimit të tij, zëvendësudrejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, vlerësoi mbështetjen e dhënë nga USAID-i për ngritjen e kapaciteteve të ATK-së që nga themelimi i këtij institucioni. Murtezaj theksoi se përkundër vështirësive, ATK-ja vazhdon ta shtojë numrin e tatimpaguesve, të rrisë kualitetin dhe ta zgjerojë gamën e shërbimeve për tatimpagues.



Kuvendi miraton buxhetin për vitin 2024

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për Buxhetin për vitin 2024 në një seancë të jashtëzakonshme të enjten në mbrëmje, e cila është braktisur nga opozita.

Nga 64 deputetë të pranishëm në sallë, 63 votuan për, ndërsa një abstenoj.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i

falënderoi deputetët për mbështetjen e projektligjit për buxhetin në një reagim në rrjetin social "Facebook" menjëherë pas votimit.

Projektligji ishte miratuar në lexim të parë gjatë një seance në nëntor. "Edhe këtë vit, për të tretin herë radhë, buxheti miratohet në muajin dhjetor ashtu edhe siç duhet", ka shkruar Kurti.

Projektligji ishte aprovuar nga Qeveria e Kosovës më 31 tetor,

ndërsa shumica e paraparë buxhetore kap vlerën e mbi 3.3 miliardë eurove - nga 3.2 miliardë sa ishte në këtë vit.

"Po vazhdojmë që ta forcojmë mbrojtjen e Republikës, rrisim sigurinë, nxitim punësimin në tregun e punës, shtojmë kujdesin për familjet, mbështesim reformat që kemi filluar dhe mundësojmë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe rrisim mirëqenien e qytetarëve në vend", ka shkruar Kurti.

Nga kjo shumë, mbi 1 miliard euro

parashihet të shkojnë për subvencione dhe transfere, mbi 850 milionë euro për shpenzime kapitale, mbi 800 milionë euro për paga dhe shtesa dhe afër 500 milionë euro për mallra dhe shpenzime.

Buxheti i vitit 2024 parasheh edhe rritjen e koeficientit të pagave nga 105 euro - sa është aktualisht - në 110.

Ndër vite një pjesë e madhe e buxhetit të shtetit ka shkruar për

sektorin e sigurisë.

Pesë institucionet me buxhetin më të madh në vitin 2024 pritet të jenë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me 931.025.963 euro, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me 265.445.995 euro, Ministria e Punëve të Brendshme me 216.523.467 euro, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës me 174.387.768 euro dhe Ministria e Mbrojtjes me 153.049.911 euro.



ZRrE-ja synon parandalimin e sulmeve kibernetike, sfidë mbetet mosliberalizimi i tregut

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka shqyrtuar planin vjetor të performancës për vitin 2024 të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Lutfije Dervishi, anëtare e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), ka paraqitur para deputetëve planin e punës për vitin 2024. Ajo tha se për vitin 2024 janë paraparë një varg aktiviteteve siç është mbrojtja e konsumatorëve dhe sulmet kibernetike, duke shtuar se sfidë për Rregullatorin mbetet



mosliberalizimi i tregut. "Si çdoherë ky plan veçse është ambicioz. Ne jemi munduar të jetë edhe racional. Për t'u

arritur objektivat rregullatori ka paraparë fuqizimin e kornizës ligjore nga ana e rregullatorit që do të dalë

nga miratimi i ligjeve në sektorin e energjisë. Legjislacioni primar do të ndikojë edhe në plotësimin ndryshimin e më shumë se 20 dokumenteve të rregullatorit. Në kuadër të integritit të tregut të përbashkët Kosovë - Shqipëri rregullatori do ta miratojë planin e performancës së përbashkët. Në kuadër të rritjes së konkurrencës së sektorit të energjisë, në proceset e rregullimeve të çmimeve, sfidë për rregullatorin ende mbetet liberalizimi i tregut. Janë propozuar disa masa

dhe në raportin e fundit rregullatori ka pasur një përmirësim të madh", ka thënë Dervishi.

Ajo ka potencuar se në fushën e planeve zhvillimore dhe bilanceve, rregullatori do të shqyrtojë dhe miratojë edhe 11 dokumente të tjera. "Në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve pritet të aprovohen rregullat për auditim të jashtëm dhe të brendshëm doganor, ndërsa në fushën kibernetike do ta aprovojmë procedurën e rikthimit në rast të sulmeve kibernetike", ka deklaruar Dervishi.

E frikshmjia që na mbron



“Argëtimi” me histori rreth rreziqeve është një strategji e frikshme, efektive dhe e vlefshme. Histori të tilla na lejojnë të mësojmë për grabitqarët e mundshëm ose situata kërcënuese që njerëzit e tjerë kanë hasur, pa pasur nevojë të përballemi vetë me to. Rreziqet e ekzagjeruara të përbindëshave të trilluar krijojnë reagime të forta emocionale dhe të sjelljes, duke na familjarizuar me këto reagime kur duhet të përballemi me më shumë rreziqe tokësore. Magjepsja jonë me gjërat që mund të na dëmtojnë ose të na vrasin nuk kufizohet vetëm tek grabitqarët. Ne gjithashtu mund të tërhiqemi nga tregimet mbi situata të tilla si shpërthimet vullkanike, pandemitë, stuhitë e rrezikshme dhe një shumëllojshmëri ngjarjesh apokaliptike. Këtu shfaqet me të vërtetë magjia e një historie të frikshme: është e vetmja mënyrë për të mësuar dhe për të stërvitur reagimin tonë ndaj rreziqeve me të cilat duhet të përballemi.

Shumica e njerëzve ndiheshin mjaft të pasigurt për të ardhmen në vitin 2020. COVID e kishte futur botën në një pandemi

globale. Qeveritë po kufizonin lëvizjen, bizneset po mbylleshin dhe mënyra e jetesës me të cilën ishin mësuar shumë njerëz, po ndalej.

Por disa prej nesh e kishin parë tashmë diçka të tillë. Më pak se një dekadë më parë, virusi meningoencefalitik 1, ose MEV-1, po bënte kërdinë. Ai u përhap me shpejtësi të tmerrshme dhe pa patur nevojë për kontakt të ngushtë në metro, ashensorë dhe hapësira publike.

Përgjigja ndaj MEV-1 parashikoi atë që do të ndodhte në vitin 2020 me COVID: udhëtimet u ndaluan, bizneset u mbyllën dhe njerëzit filluan të grumbullonin furnizime. Disa prej tyre filluan të reklamojnë kura të dyshimta si mrekullibërëse.

Nëse nuk e mbani mend shkatërrimin mbarëbotëror të MEV-1, nuk duhet të keni parë filmin “Contagion”, një thriller i vitit 2011 me aktorë Matt Damon, Kate Winslet dhe Laurence Fishburne. Atyre që e kishin parë, mund t’u ketë sjellë dobi kur COVID u përhap në të gjithë planetin.

Në një studim në muajt e parë të pandemisë, ata që kishin parë të paktën një film me temë pandemike raportuan se

ndiheshin shumë më të përgatitur për surprizat që kishte rezervuar COVID. Grumbullimi i furnizimeve, mbyllja e bizneseve, ndalimet e udhëtimit dhe kurat mrekullibërëse ishin të gjitha gjërat që fansat e “Contagion” i kishin parë; ata kishin luajtur tashmë me idenë e një pandemie globale përpara se të ndodhte ajo e vërteta.

Të mësuarit për të rifituar qetësinë dhe përshtatur përballë befasisë dhe pasigurisë duket të jetë një funksion kyç evolucionar i lojës. Angazhimi në lojë, që simulon situata rrezikuese i ndihmon gjitarët e mitur si këlyshët e tigrin dhe këlyshët e ujkut të praktikojnë shpejt e qetësisë emocionale. Këtë e bëjnë edhe njerëzit. Kini parasysh një festë në oborrin e shtëpisë ku fëmijët e vegjël bërtasin nga frika dhe kënaqësia teksa ndiqen pas nga një prind që po argëtohet, i cili kërcënon, me krahët e shtrirë në pozë përbindëshi, “Do të të kap!” Gjithçka është thjesht argëtim dhe lojë, por është gjithashtu një shans për fëmijët që të përqipen të mbajnë kontrollin motorik kur gjenden nën stres, në mënyrë që të mos bien në tokë.

Studiuesit që studiojnë argëtimin dhe lojërat e njerëzve kanë argumentuar se rënia e lojërave emocionuese dhe të pastrukturuara gjatë dekadave të fundit ka kontribuar në një rritje të ankthit në fëmijëri, gjatë po kësaj periudhe kohore. Këndet e lojërave të shkollave dhe parqet kanë qenë arena për këtë lloj loje, por një theks i shtuar në sigurinë e këndeve të lojërave ka hequr këtë mundësi. Mos të keqkuptohemi: siguria është gjë e mirë. Shumë kënde lojërash të së kaluarës ishin të rrezikshme, me shkallët që ngjiteshin deri 20 metra në rrëshqitëse të ndryshkura. Por bërja e këndeve të lojërave tepër të sigurta dhe sterile mund të ketë pasojat të padëshiruara, duke përfshirë privimin e fëmijëve nga mundësitë për të mësuar për veten dhe aftësitë e tyre për të menaxhuar situata sfiduese dhe të frikshme. Fëmijët duhet të jenë në gjendje të ushtrorin njëfarë pavarësie, e cila shpesh përfshin një lojë të rrezikshme. Çfarë mund të mësojmë nga prirja njerëzore për lojëra të frikshme? Së pari, mos kini frikë të dilni atje përjashtë dhe të eksploroni botën tuaj, edhe nëse ndonjëherë kjo shkakton pak

frikë. Së dyti, sigurohuni që kurioziteti juaj po ju edukon për rreziqet në një mënyrë që është e dobishme për ju. Me fjalë të tjera, mos ngecni duke kërkuar lajme shqetësuese në internet; është një kurth kurioziteti morbid që, ashtu si karamelat, ju mban si konsumues, por nuk bën asgjë për të kënaqur nevojën tuaj për nxitje.

Në vend që të kaloni orë pa fund duke shfletuar lajme negative, merrni një ose dy tema për të cilat dëshironi të dini më shumë dhe bëni një zhytje më të thellë që ju bën të ndiheni të kënaqur që keni vlerësuar rrezikun dhe jeni fuqizuar për të bërë diçka.

Ju gjithashtu mund të tregoni ose dëgjoni histori të frikshme me të tjerët dhe t’i përdorni ato si një pedanë, për të menduar për rreziqet reale me të cilat përballemi. Shikoni një film për një apokalips, shkoni në një shtëpi të braktisur, vishuni me kostum për të shkuar në një “festë zombie” ose kaloni një natë argëtuese në shtëpi duke biseduar me miqtë se si do t’i mbijetoni fundit të botës. Dhe në fund, nxisni kreativitetin dhe luani në hapësira ku graviteti i një situatë përndryshe mund të jetë dërrmues.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Derbi i së shtunës në Ferizaj, të dielën në Prishtinë

FERIZAJ, 15 DHJETOR - Në fundjavë zhvillohen ndeshjet e xhiros së 14-t të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Është kjo xhiroja e fundit për këtë vit e kampionatit të Kosovës. Xhiroja nis me ndeshje derbi dhe pritet të jetë e fortë dhe interesante. Të shtunën nga

ora 19:00 takohen Kastrioti dhe Besa Famgas. Besa është kampione në fuqi dhe skuadër dominuese në dekadën e fundit. Por ka pasur vështirësi në udhëtimet e fundit në Ferizaj, ndërsa këtë edicion tashmë i ka tri humbje. Humbjen e katërt synon t'ia shkaktojë Kastrioti,

që po ka synime gjithnjë e më të mëdha këtë edicion. Natyrisht, pejanët udhëtojnë për pikë të reja dhe për ta vazhduar garën për pozitën e parë. Vendasit shpresojnë t'i ndalin pikët për vete. Besa Famgas është e dyta me 20 pikë. Kastrioti është i katërti me 16 pikë.

Tri ndeshjet e tjera janë të dielën. Ndeshja më e fortë pritet të jetë ajo në mes të Prishtinës dhe Trepçës, që zhvillohet nga ora 17:00 në Bardhosh. Trepça është e treta me 18 pikë, kurse Prishtina e pesta me 14 pikë. Lideri i klasifikimit, Rahoveci, llogaritet në dy pikë të reja. E



pret Deçanin nga ora 18:00. Po nga ora 18:00 takohen edhe Vushtrria dhe Vëllaznimi.

Përballja e rivalëve në basketbollin e Kosovës

PEJË, 15 DHJETOR - Java e 13-të në elitën e basketboll do ta sjellë përballjen e rivalëve në basketbollin e Kosovës apo skuadrave me traditë dhe trofe në basketbollin e Kosovës. Takimi i parë i së shtunës është ndërmjet Trepçës dhe Bashkimit, që pritet të jetë shumë interesant. Mitrovicasit janë në vendin e parë me dhjetë fitore e dy humbje, kurse prizrenasit kanë katër fitore e tetë humbje, por së fundi kanë bërë ndryshime në shtabin teknik, duke emëruar ish-trajnerin e "Xehetarëve", Aleksandar Jonceviski. Mitrovicasit kishin fituar duelin përballë prizrenasve në Prizren 77:99. Sfida e dytë e së shtunës pritet të jetë edhe më e "zjarrtë" në mes të Pejës dhe Sigal Prishtinës. Përballja e rivalëve gjithmonë ka qenë interesante e kështu pritet edhe kësaj radhe. Verdhezinjtë kanë nëntë fitore e tri humbje, kurse prishtinasit shtatë fitore dhe pesë humbje. Duelin e parë të këtij edicioni e kishin fituar kampionët e Kosovës, 80:95. Synimi i vetëm i dy skuadrave është fitorja në këtë

sfidë. Ndeshje, po ashtu interesante, pritet ndërmjet Proton Cable Prizrenit dhe Golden Eagle Yllit që zhvillohet të dielën. Prizrenasit kanë katër fitore dhe tetë humbje, ndërsa therandasit shtatë fitore e pesë humbje, duke e bërë sfidën shumë të barabartë dhe të dy skuadrat luajnë për fitore për të pasur plasman sa më të mirë në renditje. Përballja e fundit zhvillohet ndërmjet Vëllaznimit dhe Istogut. Kuqezinjtë kanë gjashtë fitore e gjashtë humbje, ndërsa istogasit kanë një fitore dhe 11 humbje, duke u renditur në vendin e fundit, ndërsa skuadra nga Gjakova renditet në vendin e pestë.

SUPERLIGA - Java 13

Të shtunën takohen:
17:00 Trepça - Bashkimi
19:00 Peja - Sigal Prishtina

Të dielën takohen:
17:00 Proton Cable Prizreni - Golden Eagle Ylli
19:00 Vëllaznimi - Istogu



Të dielën derbi Ballkani - Prishtina



PRISHTINË, 15 DHJETOR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 18-të në Superligën e Kosovës në futboll. Tri ndeshje do të zhvillohen sot (e shtunë), dy të tjera do të jenë në program të dielën. Derbi i kësaj jave do të zhvillohet në Suharekë. Kampioni në fuqi i elitës, Ballkani, do të jetë nikoqir i Prishtinës. Suharekasit vijnë në këtë ndeshje pas humbjes nga Llapi 5-3 dhe eliminimit nga Liga e Konferencës dhe do të kërkojnë

këndelljen ndaj kryeqytetasve. Prishtina është në pozitën e pestë në tabelë me 25 pikë. Të dielën, po ashtu, luhet ndeshja në mes të Lirisë së Prizrenit dhe Llapit. Prizrenasit gjenden në vendin e fundit dhe në krizë të rezultateve, ndërsa llapjanët do të tentojnë ta mbajnë formën e mirë dhe ta ndjekin Ballkanin në luftë për titull. Të shtunën zhvillohen ndeshjet: Fushë-Kosova - Feronikeli 74, Dukagjini - Gjilani

dhe Drita - Malisheva. Të gjitha këto takime nisin nga ora 13:00.

SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
Fushë Kosova - Feronikeli 74
Dukagjini - Gjilani
Drita - Malisheva

Të dielën takohen:
Ballkani - Prishtina
Liria - Llapi

Anëtarët e KOK-ut, pjesë të komisioneve të Komitetit Ekzekutiv të Lojërave Mesdhetare

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Komiteti Ekzekutiv i Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG) ka formuar komisionet e reja për

periudhën 2024-2026. Sërish anëtarët e KOK-ut janë përfshirë në komisione. Krahas sekretarit të përgjithshëm, Besim Aliti, që është emëruar anëtar i

Komisionit Koordinues për Lojërat Mesdhetare Taranto 2026, udhëheqësi i Departamentit për Media dhe Komunikim, Kushtrim Krasniqi, është emëruar

anëtar i Komisionit për Komunikim dhe Marketing. Krasniqi është anëtar edhe i Komisionit për Komunikim dhe Marketing në Komitetin Olimpik të Evropës (EOC).



Duka për medien turke: Synojmë ta kalojmë grupin në 'Euro 2024'

TIRANË, 15 DHJETOR - Presidenti i FShF-së, Armand Duka, për kanalin turk "TRT World" foli për edicionin shumë të mirë të Shqipërisë në fushatën kualifikuese. Për sa iu përket finaleve të Evropianit, Duka ka thënë se objektivi kryesor është kualifikimi në raundin tjetër.

"Për ne është një sukses i madh që jemi pjesë e Evropianit dhe tani duhet të përgatitemi. Uroj që të gjithë lojtarët t'i kemi mirë me shëndet në mënyrë që të përgatitim çdo gjë mirë. Ne kemi një grup shumë të vështirë me skuadra shumë të mëdha. Italia, kampione e

Evropës në fuqi, Spanja kampione e Evropës dhe Botës dhe Kroacia, skuadër shumë e mirë. Por besoj që të gjithë skuadrat në Evropian janë shumë të forta. Çdo skuadër ka kualitet, edhe Turqia. Unë mendoj që Turqia ka kualitet për të arritur në finale, pse jo

për ta fituar edhe Evropianin, po ashtu edhe Serbia, të gjitha ekipet. Për ne e rëndësishme është të bëjmë një performacë të mirë në grup dhe objektivi ynë është të kualifikohemi më tej. Shpresoj ta arrijmë këtë objektivi. Gjithsesi ne kemi arritur një sukses të madh dhe



jemi pjesë e 'Euro 2024', ka deklaruar Duka.

Prishtinës i vijnë oferta nga jashtë për tre lojtarë, dy janë të parezistueshme

Prishtinë, 15 dhjetor - Drejtori gjeneral i Prishtinës, Artan Osmani, ka thënë se në adresë të klubit kanë ardhur tri oferta nga klube jashtë vendit për lojtarë kyç të skuadrës. Osmani tha se klubi nuk kishte planifikuar të ndërhynte në afatin kalimtar të janarit, por ofertat serioze nga jashtë do ta ndryshojnë këtë plan. "Ne aktualisht jemi duke u ballafaquar me një problem tjetër, nuk kemi menduar të bëjmë ndërhyrje në afatin kalimtar të janarit sepse edhe një grup të lojtarëve që e kemi pasur të lënduar, të gjithë kthehen. Tash kemi problem pak sepse kemi disa klube të interesuara për dy apo tre lojtarë kyç tanë dhe kanë ardhur me oferta konkrete dhe lojtarë për të cilët nuk kemi zëvendësim. Problemin më të madh e kemi se si t'i mbajmë këta që i kemi aktualisht", ka thënë Osmani. "Nga jashtë natyrisht edhe ne si klub nuk i kemi bërë pengesë asnjë lojtari sepse natyrisht që mundësia e zhvillimit dhe promovimit është më e madhe jashtë, andaj në



situatë të tillë nëse vendos klubi që këta dy, tre lojtarë të transferohen jashtë, atëherë na duhet të intervenojmë me urgjencë, përndryshe nëse arrijmë ta mbajmë skuadrën aktualisht siç e kemi dhe me kthimin e lojtarëve të lënduar, nuk kemi nevojë të bëjmë ndërhyrje në janar", ka shtuar Osmani. Duke mos dashur t'i zbulojë klubet e interesuara, Osmani ka thënë se shkaku i këtyre ofertave Prishtina praktikisht do të mbetet së paku pa dy lojtarë

thelbësorë në janar, raporton "KosovaPress". "Është hera e parë që po flasim në kamera, të paktën njëra prej tyre është e parezistueshme, ose dy në fakt. Por, njëra definitivisht do të jetë shumë vështirë të refuzohet. Të tjerat pastaj mund të negociohen, pro përfundimisht me shumë gjasë do të mbesim pa dy lojtarë. Nëse kjo ndodh atëherë detyrimisht do të na duhet të intervenojmë të paktën me dy lojtarë", bëri me dije Osmani.

Bostoni dhe Minnesota udhëheqin dy Konferencat, Golden State në krizë e jashtë 'play-off'-it



Boston, 15 dhjetor - Kampionët e Denverit fituan me rezultat 124-101 ndaj Brooklynit në takimin e radhës në NBA, duke qenë të dytët në Konferencën e Perëndimit. Dallimin në ndeshje e bëri Nikola Jokiq, autor i një "triple double" (26 pikë, 15 rebounde dhe 10 asistime). Në vendin e parë ndodhet Minnesota,

që mundi me rezultat 119-101 Dallasin. Reid me 27 pikë ishte shënuesi më i mirë për Minnesotan, surpriza e këtij edicioni, ndërsa 39 pikët e Donqiqit për Dallasin mbetën për statistikë. Në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes është Bostoni, që mposhti me rezultat 116-107 Clevelandin. Të gjithë titullarët e

Celticsit realizuan mbi 10 pikë (Tatum 27 pikë). Vijon momenti negativ për ekipin e Golden States, që u mund me shifrat 121-113 nga clippersat, duke dalë edhe nga zona "play-off". Thompsoni realizoi 30 pikë, por që s'mjaftuan, ndërsa për clippersat u dalluan Hardeni me 28 pikë e Leonard me 27. Befasoi Chicago, që falë një loje të mirë kolektive mundi me rezultat 124-116 Miami.

REZULTATET

Boston - Cleveland	116-107
Miami - Chicago	116-124
Dallas - Minnesota	101-119
Denver - Brooklyn	124-101
Portland - Utah Jazz	114-122
Sacramento - Oklahoma	128-123
Clippers - Golden State	121-113

Dënim i përjetshëm për presidentin e Ankaragucut

Presidenti i Ankaragucut, Faruk Koca, është pezulluar përjetë për shkak të grushtit ndaj gjyqtarit Halil Umur Meler. Ndërkohë, klubi i Superligës turke është gjobitur me 60 mijë euro dhe do

të luajë me dyer të mbyllura pesë ndeshjet e ardhshme shtëpiake. Koca humbi kontrollin e nervave pas ndeshjes Ankaragucu - Rizespor që përfundoi në barazim 1-1 falë golit të skuadrës

mike në minutën e shtatë shtesë. Më pas dha dorëheqje, duke deklaruar se asgjë nuk mund ta justifikonte dhunën e ushtruar prej tij ndaj kryesorit të sfidës. "Kam dhënë dorëheqje nga

postin e presidentit në mënyrë që të parandaloj që Ankaraguci, tifozët dhe familja ime, të pësojnë dëme të mëtejshme", ka deklaruar 59-vjeçari. Koca vijon të jetë në paraburgim bashkë me

dy persona të tjerë që goditën gjyqtarin Meler, me këtë të fundit që pësoi traumë në kokë nga goditjet. Kampionati turk i futbollit do të rifillojë më 19 dhjetor.

SHKURT

Hasani në janar largohet nga Tirana

Sulmuesi Florent Hasani pritet të largohet nga Tirana në afatin kalimtar të janarit. Në fakt, Hasani pritej të largohej që në merkaton e verës, përpara se të niste ky sezon, por në fund palët e përfshira nuk gjetën gjuhën e përbashkët. Në këto kushte, ku në fund të këtij edicioni rrezikojnë ta humbasë falas, Tirana nuk do të bëhet më pengesë, Florent Hasani pritet të largohet gjatë merkatos së dimrit duke i dhënë fund bashkëpunimit me Tiranën. Nga shitja e Hasanit skuadra shqiptare pritet të përfitojë një shumë të majme, rreth 500 mijë euro. Sulmuesi nga Kosova është aktualisht golashënuesi më i mirë i Superligës me 10 gola të shënuara.

Leclerc: Për t'u shpallur kampion bote me Ferrari ia vlen të presësh disa vjet

Charles Leclerc e ka përsëritur disa herë, por së fundi i ka premtuar sërisht besnikëri Ferrari. Kontrata e menegaskut me "kokëkuqen" skadon pas një viti, por gjasat janë që ajo të shtyhet deri në vitin 2029. Duket se Leclerc është gatë të presë për ta fituar titullin kampion në Formula 1 me makinën italiane pavarësisht prej problemeve që ajo ka shfaqur. "Me kalimin e kohës jam bërë më i vjetër dhe më i pjekur. Nëse kam mësuar një gjë të Ferrari është durimi. Ëndrra e jetës time është të shpallej kampion bote me Ferrarin dhe ky është objektivi për të cilin nuk sforcohem, por pres. Duhet të mendosh për një afat më të gjatë, ndaj ia vlen të presësh", ka deklaruar Leclerc. Përveç durimit, monogasku ka mësuar të garojë edhe nën presion: "Ferrari është Ferrari dhe këtu ka një pasion ndryshe. Kushdo që firmos një kontratë me këtë makinë, si një pilot apo një punonjës i thjeshtë, duhet të pranojë se punon nën një presion ndryshe nga makinat e tjera. Për mua kjo s'është problem".

Henry, Mbappe: Qëndro në PSG

Pas dy javësh Kylian Mbappe do të jetë i lirë të diskutojë transferimin e mundshëm me çdo klub, pasi kontrata e tij me Paris Saint-Germainin është caktuar të skadojë në qershor të 2024-s. 24-vjeçari ka qenë prej kohësh një objektivi i lakmuar për Real Madridin dhe ky dimër thuhet se është përpjekja e fundit që "Los Blancos" do të përpiqet ta transferojë francezin në "Santiago Bernabeu". Legjenda e Francës dhe Arsenalit, Thierry Henry, e ka këshilluar sulmuesin e gjithanshëm të mbetet në "Parc des Princes" deri në fund të karrierës. "Po të isha Kylian Mbappe nuk do të largohesha. Do të doja të përfundoja atë që kam filluar. Dua të them, pse duhet të largohet? Ai e do Parisin, ka lindur në atë qytet, këtë duhet ta kuptoni. Unë dua që ai të qëndrojë deri në fund", ka thënë Henry për "CSB Sports".

Casemiro në janar mund t'i bashkohet PSG-së

Largimi i mesfushorit brazilian Casemiro nga skuadra e Manchester Unitedit duket të jetë i pashmangshëm. 31-vjeçari është në sezonin e tij të dytë me "djajtë e kuq", por këtë vit nuk po shkëlqen dhe problemet fizike e kanë ndaluar disa herë. Për këtë arsye ai mund të largohet që në janar pavarësisht prej kontratës që ka me Manchester Unitedin deri në vitin 2026. Sipas "The Sun", për mesfushorin është interesuar ekipi i PSG-së. Përvoja e Casemiros mund të jetë një armë më shumë për francezët në arenën ndërkombëtare, ndaj po këmbëngulin në këtë transferim. Për brazilianin janë interesuar edhe nga Arabia Saudite.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 15.12.2023 bënë shpallje publike për dhënie me pronës së paluajtshme me qira.

Rishpallje Publike

T-23-15

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça SH.A.
Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000
Personi Kontaktues: Behxhet Nimani
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com
Telefoni: +381 28 538 050
Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qera e Parcelës të njësisë Biznisore Industria Kimike që gjindet prë magjistrale së Adriatikut

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë

Data e shpalljes: 15.12.2023

Sqarimi: deri me 22.12.2023

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 22.12.2023
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Origjinali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 22.12.2023 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Departamenti i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës te pa paguara.

Shënime shitesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madhe apo i barabarte me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe të gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1

OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T?)	

Përmbledhje		Çmimi
a	m ²	
b	Çmimi për metër	
c = a * b	Çmimi me TVSH	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbytësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund te behet deri me datën 20.12.2023 për mes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e aseteve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

DHËNIE ME QERA E PARCELËS

Oferta duhet të jepet për m²

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Omel coffee and cakes” L.L.C. me seli në Gjilan, me pronar Lira Dërmaku, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 812021608 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavaje se svi klienti da drustvo sa “Omel coffee and cakes” L.L.C. Gnjilane, sa vllasnikom Lira Dërmaku, donelo odluku o prestani rada sa nr. 812021608 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Omel coffee and cakes” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Lira Dërmaku, has come to the decision to quit its business: 812021608 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Teuta Haliti shpall të pavlefshme Diplomën e Kolegjit “Fama” Prishtinë, drejtimi Bachelor i Arteve Psikologji e Përgjithshme.

- Teuta Haliti shpall të pavlefshme Diplomën e Kolegjit “Fama” Prishtinë, drejtimi Bachelor i Arteve Psikologji e Përgjithshme.

Gezuar Selimaj shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

Sali Bubani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Mati Ligoreci” Prizren.

Lulzim Zyberi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

Fevzi Vasija shpall tr pavlefshme certifikatën dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

Bislim Thaçi shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

